

Plani i Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen për Fëmijët në Situatë Rruge (2015-2017)

Sipas Studimit kombëtar për fëmijët në situatë rrugë në Shqipëri (2014), në vendin tonë janë identifikuar mes 2014 dhe 2527 fëmijë që jetojnë në situatë rruge. Mbi 700 prej tyre u identifikuan në Tiranë. Fëmijët në situatë rruge janë ndër grupet më vulnerabël dhe shpesh herë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Me synim përmirësimitin e gjendjes të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” në 2014. Me synim integrimin e fëmijëve në situatë rruge në sistemin arsimor, është bërë zgjerimi i Marrëveshjes aktuale që përfshin Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje është hartuar një Plan Veprimi ndërinstitucional për periudhën 2015-2017 për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. Ky plan është hartuar pas një procesi konsultimi gjithëpërfshirës ndërsektorial, ku janë përfshirë aktorë nga institucionet qëndrore dhe vendore dhe organizatat partnere që mbështesin procesin. Plani u ndërmorr si një bashkëpunim ndërinstitucional ku pjesë thelbësore e ndërhyrjes do të jetë Drejtoria e Policisë Tiranë, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Bashkia Tiranë, Institucionet e Arsimit, Shëndetësisë, Punësimi, Drejtësisë dhe një grup organizatash me ekspertizë dhe shërbim ofruese për fëmijët në rrezik, në situatë rruge si dhe për familjet e tyre.

Qëllimi i Planit të Veprimit është mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës përmes një ndërhyrjeje të koordinuar ndërsektoriale dhe një përfaqje të integruar gjithëpërfshirëse në mbrojtje të interesave më të larta të fëmijës dhe mbështetjes së familjeve si dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve për një jetë dinjitoze dhe për të jetuar me familjet e tyre, larg dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit.

Plani i veprimit përfaqon një përfaqje të bazuar mbi një model sistemik, ndërsektorial dhe të integruar të mbështetur në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Një përfaqje e tillë mund të jetë e suksesshme vetëm nëse arrihet një balancë e mirë mes ndërhyrjeve të menjëhershme emergjente, ku ofrohet ndihma e menjëhershme, dhe planifikimit afatgjatë për të synuar parandalimin e fenomenit dhe ndërhyrje me metoda të ndryshme ndaj fëmijëve dhe që synojnë që fëmija të vazhdojë të qëndrojë pranë familjes. Një tjetër aspekt thelbësor është mbështetja e familjes në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Duhet theksuar se procesi i riintegritimit është një proces gradual dhe delikat dhe kërkon shërbim këshillimi për fëmijët dhe familjen, ndërtimin e besimit, ndihmë në zgjidhje konfliktesh dhe ndihmë e mbështetje financiare. Gjithashtu, duhet të theksohet se rastet e fëmijëve në situatë rruge, vlerësohen si raste të rrezikut të lartë, ndaj të cilëve duhet të reagojnë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve përmes programeve intensive për familjen, fëmijën etj. Megjithatë, njëkohësisht duhet të theksuar se hartimi i një plani ndërhyrjeje për familjen dhe fëmijën është domosdoshmëri për të mos lejuar që situata të vazhdojë të rëndohet.

Në rastet kur prindërit nuk janë në gjendje ose nuk duan të vazhdojnë të kujdesin dhe mbrojnë fëmijën, atëherë duhet të merret në konsideratë zhvendosja e fëmijës nga ky mjedis familjar, i cili më tepër sesa ndihmon, e dëmton fëmijën. Ndonëse besohet se situata e fëmijëve në rrugë është një pasojë e krizës ekonomike, sociale dhe të vlerave, është gjithashtu përgjegjësi e shtetit për të ndërhyrë nëse familja ose kujdestarët nuk e pranojnë ndihmën, nuk kanë kapacitetin për të ofruar ndihmë dhe kujdes për fëmijën dhe nuk duan të ndryshojnë. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luan Policia, Prokuroria dhe Gjykata. Ky proces, kërkon trajtim të kujdesshëm dhe në përputhje me Interesin më të Lartë të Fëmijës si dhe KDF-në. Po ashtu, në rastet kur fëmijët janë qartësisht subjekte të shfrytëzimit, trafikimit atëherë duhet të vihet në lëvizje mekanizmi kombëtar i trafikimit të qenieve njerëzore (përmes Koordinatorit Kombëtar Anti-trafik). Duhet theksuar se në shumë vende dhe në disa raste në Shqipëri, ndërhyrja e shtetit ndaj fenomenit ka qenë ndëshkuese dhe e dhunshme. Kjo nuk ka rezultuar e suksesshme si për fëmijët dhe për familjet dhe për më tepër nuk ka adresuar rrënjët e problemit. Njëkohësisht, adresimi i fenomenit nuk ka një “recetë” të gatshme; cdo rast është unik dhe duhet të trajtohet me një qasje individuale ndaj fëmijës dhe familjes duke përdorur metodën e menaxhimit të rastit.

Parimet Drejtuese të Bashkëpunimit Ndërsektorial:

- Interesi më i lartë i fëmijës
- Mos-diskriminimi
- E drejta për mbijetesë, zhvillim dhe mirëqenie
- Respekti për pikëpamjen e fëmijës (në përputhje me moshën dhe kapacitetin zhvillimor).
- Konfidencialiteti.

- Mbrojtja e familjes

maj 2014 nisi zbatimi i PV në Tiranë me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nëpërmjet një qasje të plotë, të integruar dhe një ndërhyrje të koordinuar ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve të tyre. Në vitin 2015, modeli i Tiranës do të zbatohet në rrethe të tjera duke marrë parasysh praktikat e mira që janë zhvilluar nga puna e NJMF-ve në Tiranë. Puna ka filluar në 6 bashki të vendit. Në 3 bashki (Elbasan, Durrës, Fier) janë hartuar planet lokale dhe është ngritur mekanizmi i bashkëpunimit ndërsektorial për ndërhyrje. Evidentimi i bashkive të tjera të rëndësishme në ndërhyrje (prej nga vijnë fëmijët) si, Shkodër, Vlorë, Korçë, etj, dhe shtrirja e tij në gjithë vendin është pjesë e planit në vazhdim. Shtrirja dhe zgjerimi i PV në gjithë vendin është synimi për 2015-2015.

Objektivi 1			
Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për të realizuar ndërhyrje të koordinuara multi-disiplinare në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge dhe ndihmë të familjeve të tyre			
Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
1.1. Krijta e përfshirjes ndër sektoriale, në veçanti të sektorëve/aktoreve si: - shëndetësia - prokuroria - marrëveshje ndër-ministore/institucionale	Marrëveshjet e firmosura	MAS/MSH/ Prokuroria	Në vazhdim 2015-2017
1.2. Hartimi i udhezimit për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge.	Udhëzuesi i hartuar	MMSR/MPB/ASHMDF/OSBE	2015-2016
1.3. Caktimi i pikave fokale të specifikuar dhe në marrëveshjen ndërministrorë nga Policia e Shtetit dhe nga strukturat antitrafik në qarqe (Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Vlorë)	Personat e kontaktit/pikat fokale të disponueshme Numri i takimeve të rregullta të realizuara	MPB/DPPSH/Koordinatori antitrafik./ ASHMDF/SHSSH	2015-2017
1.4. Takime tre-mujore reflektuese të nevojave, raportuese dhe llogaridhënie mes përfaqësuesve të institucioneve pjesë e Task Forcës për Tiranën (Koord. anti- trafik, Drejtoria e Policisë, Drejtoritë Arsimore, Shërbimi i Punësimit, Shërbimi Social, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Autoriteti Shëndetësor Rajonal dhe OJF si vëzhguese)	Raporte progresi periodike Minutat e takimit Numri i takimeve të rregullta të realizuara	ASHMDF/Koordinatori kombëtar, Policia e Shtetit /Shërbimi i Kombëtar i Punësimit/	çdo 3- muaj
1.5. Organizimi i mbledhjeve periodike të Bërthames me qëllim koordinim, monitorimin e ecurisë së punës dhe sjellja e problematikave nga terreni	Takime të realizuara me bërthamën/ Takim për hartimin e termave të referencës të Bërthamës / Raportet statistikore sipas treguesve të monitorimit	ASHMDF/SHSSH/Bërthama	çdo 2 javë

1.6.Hartimi i planeve lokale dhe ngritja e mekanizmit të bashkëpunimit ndërsektorial për ndërhyrje në bashki të reja (Elbasan, Durrës, Fier, Shkodër, Vlorë, Korçë, etj.)	Mekanizmi i koordinimit i ngritur. -Plani i firmosur nga kryetari/ -numri i Bashkive të përfshira/ -raporte mujore/ -numri i skuadrave të terrenit të ngritura	Shërbimet sociale në Bashkitë e përfshira/ASHMDF	cdo 4 muaj 2015-2017
1.7. Takime periodike raportuese dhe llogaridhënie mes përfaqësuesve të mekanizmit të koordinimit në nivel lokal dhe nga Drejtoria e Policisë, Drejtoritë Arsimore, Shërbimi i Punësimit, Shërbimi Social, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në qarqet perkatëse .	Takimet e realizuara, minutat e takimit	Institucionet e arsimit, policise, shendetesise në nivel lokal	2015-2017 cdo tre muaj
1.8. Bashkëpunimi me OJFte që punojnë në nivel lokal si dhe qendrat që ofrojnë shërbime për fëmijet vulnerabel dhe fëmijet në situatë rruge për zbatimin e planit të ndërhyrjes në nivel lokal.	Numri rasteve të përbashkëta të marra në mbrojtje	NJMF/ Shërbimet sociale në bashkitë përkatëse, OJF partnere	Në vazhdimësi
1.9. Hartimi i planeve të nderhyrjes për FSR në gjithë bashkitë e vendit			2015-2017

Objektivi 2
Koordinimi me vendet fqinje për referimin e rasteve të fëmijëve në lëvizje dhe menaxhimin ndër-kufitar

Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
2.1.Takim bilateral në Kosovë dhe Greqi për identifikimin e problematikave të fëmijëve në lëvizje dhe në veçanti atyre në situatë rruge - Ngritja e një grupi pune për zbatimin e rekomandimeve të dala nga takimet në Kosovë/Greqi	Takime të realizuara Grupi i punës i ngritur	MPB/, Koordinatori Kombëtar ASHMDF /SHSSH	Në vazhdim 2015
2.2.Takim bilateral në Kosovë dhe Greqi për identifikimin e problematikave të fëmijëve në lëvizje dhe në veçanti atyre në situatë rruge	Takime të realizuara	MPB/ Koordinatori Kombëtar ASHMDF /SHSSH/	Në vazhdim
2.3.Ngritja e një grupi pune për zbatimin e rekomandimeve të dala nga takimet në Kosovë/Greqi	Grupi i punës i ngritur	MPB/Koordinatori kombëtar/ASHMDF/SHSSH/or ganizata partnere	2015
2.4.Draftimi i një protokollit për fëmijët në lëvizje mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë/Malit të Zi/Greqisë		MPB/Koordinatori kombëtar/ASHMDF/SHSSH/or ganizata partnere.	
2.5.Rishikimi i procedurave dhe dhënia e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit	Procedurat e rishikuara për dhënien e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit	ASHMDF Zyrat e gjendjes civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe çdo organ tjetër publik e jopublik që operon në fushën e të drejtave të fëmijëve	2015 në vazhdim

Objektivi 3:
Identifikimi dhe forcimi i shkëmbimit të informacionit për t'u ardhur në ndihmë familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge

Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
3.1.Hartëzimi dhe rifreskimi cdo 6 muaj në nivel lokal i hartës së shërbimeve që ofrohen për fëmijët dhe familjet në situatë rruge	Harta e shërbimeve e plotësuar	NJMF /SHSSH/ OJF qe ofrojnë shërbime për fëmijët	Cdo 6 muaj
3.2.Vazhdimësia e funksionimit të grupeve të terrenit në Tiranë për identifikimin Pro-aktiv.	Infomacionet e ndara dhe shërbimet e ofruara		2015 ne vazhdim
3.3.Ngritja e grupeve të terrenit që do punojnë për identifikimin proaktiv në bashkite e reja	Hartimi i raporteve të konstatimit në mënyre të rregullt nga skuadrat e terrenit.		Prill-Maj 2015 e ne vazhdim
3.4.Koordinimi për shkëmbimin e informacionit mes bashkive të përfshira në zbatim të PV		NJMF , bashkitë përkatëse Grupet e interesit nga shoqëria civile/donatorë/OJF/ASHMDF	2015-2017
3.5.Forcimi i bashkëpunimit me qendrat ditore publike dhe jo publike për trajtimin e rasteve të referuara të fëmijëve në situatë rruge.	Trajnime per personelin e qendrave Rastet e trajtuara		
3.6.Standartizimi dhe hartimi i politikave për sigurimin e një pakete ndihme dhe përkujdesi për fëmijët dhe familjet të cilat do të merren në mbrojtje (p.sh.:ndihmë ushqimore, pagesë qiraje për një periudhë të caktuar kohore, veshmbathje për familjen, mbështetje me ndihmë ekonomike, formim profesional, ndjekja e fëmijës përmes një qendre ditore/komunitare)	Paketat e ndihmes te standartizuara	Bashkitë përkatëse/ NJMF/ OJF	2015-2017
3.7. Identifikim dhe analizë e shërbimeve të munguara dhe asaj çfarë mund të përmirësohet dhe sigurimin e vazhdimësisë së tyre	Raport dhe listim i shërbimeve të munguara që duhen përmirësuar në bashkite përkatëse Paketa e ndihmës dhe përkujdesit	MMSR, /SHSR/ organizatat partnerë	2015 dhe në vazhdim
3.8.Konsultime të vazhdueshme me grupin e organizatave të shoqërisë civile si dhe donatorë të mundshëm për t'u kontraktuar për mbështetjen në veçanti të programit e asistencës për familjet dhe qendrat ditore dhe ato rezidenciale.	Konsultimet e realizuara Kontratat e nënshkruara	NJMF/ Bashkitë e përfshira në zbatimin e planit(Fier, Durres, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër)	2015 dhe në vazhdim
Objektivi 4			
Rritja e aksesueshmërisë për familjet në situatë rruge në shërbimet bazë të arsimit, shëndetësisë, punësimit.			
Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
4.1.Regjistrimi në gjendjen civile të fëmijëve të paregjistruar për të rritur aksesin në të gjitha shërbimet e tjera.	Fëmijët e regjistruar në gjendjen civile	MPB, Njesitë vendore, njmf/administratore sociale. Sherbimi ligjor falas	Shtator 2015 e në vazhdim
4.2. Identifikimi dhe regjistrimi i femijeve në situatë rruge te paregjistruar ne arsimin e detyrueshem dhe ne programet parashkollore dhe transmetimii listave prane DAR-eve	Femijët në situatë rruge të regjistruar dhe që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrave	NJMF/MAS/ drejtoritë arsimore rajonale	

4.3.Krijimi i programeve specifike per fëmijët 9-16 vjec që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë ose e kanë braktisur atë.	Programet e realizuara /Nr i fëmijëve , pjesë e këtyre programeve		
4.4.Ofrimi i teksteve shkollore falas	Shperndarja e teksteve per FSR te regjistruar ne shkolla	MAS/DAR	Shtator 2015 e në vazhdim
4.5.Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopshte për fëmijet në situatë rruge sipas udhëzimit të MAS-Referimi i fëmijëve që braktisin shkollën në njësitë e mbrojtjes së fëmijëve	Numri i femijeve qe shkojne ne shkollë me transport falas/ numri i femijeve te referuar qe braktisin shkollën	MSH/ASHR	2015-2017
4.6.Sigurimi i shërbimit shëndetësor në cerdhe	Numri i fëmijëve te regjistruar ne cerdhe sipas nevojave	MSH/ASHR	
4.7.Përmirësimi i politikave në nivel kombëtar për shërbime aksesit në cerdhe		Bashkite përkatëse/ NJMF	2015-2017
4.8.Rritja e aksesit në shërbimin shëndetësor përmes përmirësimit të procedurave për ofrimin e shërbimit shëndetësor për fëmijët në situatë rruge.	Udhëzime te posacme	MSH/ASHR/ Drejtoritë rajonale shëndetësore	2015-2017
4.9.Regjistrimi i fëmijëve të paregjistruar ne qendrat shendetesore	Femijë të regjistruar në qendra shëndetësore Realizimi i regjistrimit		
4.10.Trajnim i punonjësve të shëndetësisë per për ofrimin e shërbimit të barabartë për fëmijët në situatë rruge ose në kushte të vështira banimi	Numri i punonjësve të kujdesit shëndetësor të trajnuar	MMSR dhe SHKP	
4.11.Përmirësimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor falas për fëmijët në situatë rruge, pajisja me kartela shëndetësore të tyre dhe Kartat e Vaksinit në qendrat shëndetësore me urdhër të vecantë të MSH dhe me ndërhyrjen e administratorit,NJMF	Fëmijë të pajisur me kartela të përgjithshme Realizimi i vaksinimit	MSH/ASHR/ Drejtoritë rajonale shëndetësore	2015-2017
4.12.Rritja e mundësive për punësim përmes krijimit të profileve për punë kerkues dhe profile ofrues punesh në përshtatje më familjet e FSR	Numri i prindërve të punësuar		
4.13.Mbështetja, shoqërimi ndërmjetësimi nga një ekip punonjësish socialë të prindërve për punësim në Tiranë	Hartimi i raporteve periodike për punësimin e prindërve	MMSR dhe SHKP	Cdo 2 jave
4.14.Pjesëmarrja e prindërve dhe të rinjve në programet e nxitjes së punësimit dhe ne në kurse të formimit profesional	Numri i personave të përfshirë në PNP dhe në kurset e formimit profesional Numri i personave të trajnuar në këto shërbime	MMSR/ SHKP/ Shërbimi social në Bashki	2015-2017
4.15.Mundësimi granteve të vogla për familjet për t'i nxitur për vetëpunësim.	Numri i familjeve që kanë përfituar grante, nr i familjeve të vetepunësuar	Zyra e punes/grupi I punesimit	
Objektivi 5: Të sigurohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge nga shfrytëzimi për punë, lypje, apo rrezik trafikimi si dhe realizimi efektiv i ndjekjes penale ndaj autorëve të dyshuar.			
Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor

5.1.Rastet e shfrytëzimit të fëmijëve, (kur familja e shfrytëzon fëmijën/nuk pranon ndihmën dhe është rezistente për të ndryshuar) referohen nga NJMF tek Policia e Shtetit dhe Prokuroria. Rastet referohen për “Urdhër të Mbrotjes” për rastet kur prindërit nuk bashkëpunojnë dhe fëmijët janë në rrezik.	Numri i rasteve nën hetim në prokurori dhe gjykatë	Policia e Shtetit, Prokuroria	Në vazhdim 2015-2017
5.2.Rastet e fëmijëve në situatë rruge të identifikuar nga Policia dhe shërbimet sociale referohen pranë NJMF-ve	Numri i rasteve te referuara	DPPSH/ASHMDF/ SHSSH, strukturat antitrafik Bashkitë përkatëse, NJMF, OJF	Në vazhdimësi
5.3.Rastet e referuara prane autoritetit anti-trafik referohen prane NJMF-se ose ASHMDF-se nese jane raste te femijeve ne situatë rruge.			
5.4.Fuqizimi i mekanizmit të ndërhyrjes emergjente të fëmijëve në situatë rrugë,në rrezik të lartë dhe të menjëhershëm.			
5.5.Monitorimi i kujdesshëm i rasteve që janë në ndihmë nga skuadrat e terrenit dhe nga Bërthama përmes kontrollit të databazës	Raportet e konstatimit te siguruar Numri i rasteve që jane në ndihme dhe shfrytëzojnë fëmijët	NJMF/OJF/ SHSSH, NJMF, Policia e shtetit, Prokurori	Në vazhdimësi
5.6.Bashkëpunimi me Strukturat antitrafik në rastet kur fëmija në situatë rruge dyshohet të jenë viktimat e mundshme apo në rrezik trafikimi..	Referim i rasteve te dyshuara Rastet e referuara të ndërsjellta	SHSSH, NJMF, Policia e shtetit, Struktura antitrafik,Prokurori	2015-2017
5.7.Analizë e bazës ligjore përsa i përket marrjes në mbrojtje dhe kujdestarisë si dhe propozime për ndryshim ligjor	Ligje të rishikuara/ndryshuara	MMSR/ ASHMDF, Ministrinë e linjës	2016-2017

Objektivi 6
Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge

Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
6.1.Trajnimi i thelluar i grupeve multidisiplinare dhe profesionistëve për fëmijë në bashkitë Elbasan, Durrës, Fier dhe bashkitë e tjera që do përfshihen për manualin dhe procedurat e punës me fëmijët në situatë rruge	Numri i anëtarëve të ekipeve multidisiplinore të trajnuar Raste të trajtuara nga profesionistët sipas procedurave (FSRr	MMSR/ MPB/ASHMDF/OJF	2015 ne vazhdim
6.2.Trajnime të thelluar për Pikat fokale të Punonjesve të Policisë dhe Operatorëve 129 mbi Procedurën/ manualin e Punës me FSRr	Trajnime te realizuara Materialet e shperndara Raste të trajtuara nga profesionistët sipas procedurave (FSRr	MMSR/ MPB/ASHMDF/OJF	Shtator-tetor 2015
6.3.Trajnime të punonjesve të policisë dhe të punonjesve për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të zbatimit të Protokollit të Mbrojtjes së Fëmijes	Shpërndarja e materialeve/ Udhëzimit / Numri i profesionistëve të trajnuar	MMSR/ MPB/ASHMDF/OJF	2015-2017
6.4.Trajnime të bazuara tek vlerësimi i nevojave dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet punonjesve nga rajone të ndryshme .	Nevojat e vleresuara dhe realizimi i trajnimeve - Raste të trajtuara nga	MMSR/ MPB/ASHMDF/OJF	2015-2017

6.5.Trajnime ne 12 qarqe te vendit (në 2015: Korçë Vlorë, Shkodër) në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Antitrafik për procedurat e punës në rrugë dhe PSV-të	profesionistët sipas procedurave PSV dhe FSR -Raste të trajtuara sipas standarteve të Sh.Mbrojtjes. -Vleresimi i njohurive të marra nga profesionistët dhe Vleresimi i trajnimeve Trajnime te realizuara	Profesionistet nga institucionet vendore per MF / bashkite perkatese/ OJF
--	---	---

Objektivi 7
Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge për lypje dhe punë dhe parandalimi i shfrytëzimit të fëmijëve për lypje apo për punë.

Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
7.1.Hartimi i një plani kombëtar komunikimi	Plani i komunikimit kombëtar i hartuar	ASHMDF/ OJF	Mars 2015
7.2.Hartimi i planeve lokale ndërgjegjësimi në bashkëpunim me Bashkitë e përfshira, NGO-të etj.	Plani i bashkive i hartuar	Strukturat e Policisë së Shtetit, Shëndetsise, OJF, ASHMDF/Drejtoria e nr 4 e formimit profesional/fakulteti i Shkencave Sociale	2015-2017
7.3.Fushata në rrugë për të informuar publikun mbi fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge.	fletpalosjet dhe mesazhet e shperndara	Aktorët e institucioneve vendore	2015-2017
7.4.Vizita në komunitet e targetuara përkatëse sipas bashkive/komuniteteve përkatëse	Vizitat e realizuara		2015-2017
7.5.Fushatë sensibilizuese në shkollat e rajoneve te perfshira	Fushata e realizuar, fletet informuese të shpërndara	Aktorët e institucioneve vendore	2015-2017
7.5.Prezantimi ,përhapja e eksperiencave pozitive të suksesit,ndërhyrjes në mediat audiovizive kombëtare	Raste suksesi ne media audiovizive dhe mediat lokale	Bërthama/ASHMDF/ NjMF, DAR,aktorët në nivel vendor/OJF, partnerët lokale/OJF	2015- 2017

Objektivi 8
Vlerësimi dhe monitorimi i PV

Aktivitetet	Treguesit	Organi përgjegjës	Afati kohor
8.1.Raportime periodike nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve	Raporte 3 mujore progresi dhe monitorimi. Raport vjetor	ASHMDF	çdo 3muaj vjetor
8.2.Raportime periodike 3 mujore nga bashkitë e përfshira	Raporte nga bashkite	Bashkitë./NJMF	cdo 3 muaj
8.3.Krijimi i një databaze të qendërsuar kombëtare dhe përditësimi në këtë sistem ekzistues me rastet e fëmijëve në situatë rruge për monitorimin e planit të veprimit dhe të familjeve në situatë rruge	Databaza me rastet e përditësuar/ Numri i rasteve të trajtuara sipas treguesve të monitorimit	ASHMDF /NJMF/ Bërthama/SHSSH/ bashkitë e përfshira	Në vazhdim
8.4.Krijimi i një sistemi on-line për mbledhjen e të dhënave në përputhje me parimin e konfidencialitetit	Sistemi On- line i aksesueshëm	ASHMDF ,OJF, Donatorë	2016
8.5.Analizë / studimi me ndihmën e ekspertëve për efikasitetin e punës dhe përmirsimet e mundshme.	Numri i rasteve të trajtuara sipas treguesve të monitorimit	ASHMDF, ekspertë, OJF	2016
8.6.Vlerësimi vjetor (2 vjecar) ecurisë së plan veprimit në nivel kombëtar dhe mbështetjes së familjeve përmes treguesve të monitorimit dhe vlerësimi	Studimi i iniciuar/ realizuar	ASHMDF, SHSSH, partnerët e përfshirë	2015, 2017

Lista e partnerëve jopublikë të Organizatave jofitimprurëse të përfshira në zbatimin e Planit të Veprimit për Identifikimin dhe Mbrojtjen për Fëmijët në Situata Rruge (2015-

UNICEF	
UNDP	
OSCE	
ARSIS	
Terre de Homme	
Save the Children	
World Vision	
SHKEJ-Shoqata Kombetare Edukim per Jeten	
FBSH - Femijet e Botes Shqiperi	
D&E- Te ndryshem te barbarte	